



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel.+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 2024/1193

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, neni 108/A paragrafi 7 dhe neni 109 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të kërkesës së datës 13.12.2024 për tërheqje nga ankesa e parashtruar nga OE N.T.P. "Begisholli" me datë 09.12.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Asfaltimi i rrugës Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufc të Ri" me numër të prokurimit "613-24-9854-5-1-1", inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) "Komuna e Lipjanit", Paneli Shqyrtues në përbërje nga Isa Hasani – Kryetar, Batisha Ibrahimimi dhe Vedat Poterqoi - Anëtar, me 19.12.2024, morën këtë:

VENDIM

1. Aprovohet, kërkesa për tërheqjen e ankesës e datës 13.12.2024, e parashtruar nga OE N.T.P. "Begisholli" me nr. 2024/1193, e datës 09.12.2024 të parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Asfaltimi i rrugës Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufc të Ri" me numër të prokurimit "613-24-9854-5-1-1", inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) "Komuna e Lipjanit".
2. I lejohet, autoritetit kontraktues – "Komuna e Lipjanit", që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Asfaltimi i rrugës Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufc të Ri" me numër të prokurimit "613-24-9854-5-1-1", përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.
3. Meqenëse parashtruesi i ankesës është tërhequr nga ankesa dhe pretendimet ankimore, duke u bazuar në nenin 31 pika 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, këtij OE i kthehet sigurimi i ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

Arsyetim

Operatori ekonomik OE N.T.P. "Begisholli" me datën 09.12.2024, ka paraqitur ankesë në OSHP, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Asfaltimi i rrugës Marie Shllaku dhe ndërtimi i urës mbi Lumin Sitnica në Rufc të Ri" me numër të prokurimit "613-24-9854-5-1-1".

Operatori ekonomik N.T.P."Begisholli" me datën 13.12.2024 ka njoftuar se tërhiqet nga ankesa lidhur me aktivitetin e sipërcituar.

Me rastin e informimit lidhur me veprimet e përshkruara si më sipër, Paneli Shqyrtues mori vendim për aprovimin e kërkesës për tërheqje nga ankesat e OE-ve ankues duke i lejuar AK që ta vazhdojë aktivitetin e prokurimit (i përshkruar si më sipër) nëse AK nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet. Krahës kësaj po ashtu duhet theksuar se efekti pezullues i ankesës në kuptim të nenit 112, paragrafi 1, të LPP sipas të cilit dorëzimi i një ankesë e obligon AK që automatikisht ta pezullojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit në rastin konkret duhet të largohet. Bazuar në faktet dhe rrethanat e përshkruara shkurtimisht si më sipër, konstatohet se janë krijuar kushtet (prezumimet ligjore) që të përfundojë procedura ankimore në këtë fazë, pa nevojë që të hapet faza e vlerësimit meritore nga paneli shqyrtues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, sepse mungon objekti ankimor (ankesa është tërhequr) dhe elementet qenësore të ankesës sipas nenit 111 të LPP;

Bazuar në faktet dhe rrethanat e përshkruara shkurtimisht si më sipër, konstatohet se janë krijuar kushtet (prezumimet ligjore) që të përfundojë procedura ankimore para OSHP në këtë fazë dhe lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, për faktin se:

- a) mungon objekti ankimor dhe elementet qenësore të ankesës sipas nenit 111 të LPP;
- b) ankuesit, i mungon statusi i palës së interesuar, sipas nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP.

Në këtë rast duhet theksuar se në kuptim të nenit 13, të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative (LPPA), secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik. Kurse në kuptim të nenit 109, paragrafi 1, të LPP, po ashtu parashihet se çdo palë e interesuar ka të drejtë të parashtojë ankesë pranë OSHP. Mirëpo, në kuptim të parimeve bazë të legjislacionit, posaçërisht parashikuar me dispozitën e nenit 93 të Ligjit për Procedurën e përgjithshme administrative, kjo njëherësh kjo nënkupton faktin se çdo palë e interesuar ka të drejtë po ashtu ta ndryshoj (plotësoj, përmirësoj, precizoj) ankesën dhe po ashtu ta tërheq atë. Në fakt, Paneli Shqyrtues ka konfirmuar faktin e tërheqjes së ankesës, bazuar në veprimet e palës përmes publikimit të tyre në platformë përkatësisht faqen zyrtare të sistemit të prokurimit publik, prandaj nuk gjeti arsye për të vepruar në kuptim të nenit 110 të LPP andaj janë krijuar kushtet që procedura në këtë çështje juridiko administrative të përfundojë në kuptim të nenit 97 të LPPA.

Meqenëse parashtruesi i ankesave është tërhequr nga ankesa dhe pretendimet ankimore, duke u bazuar në nenin 31 pika 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, OE i kthehet sigurimi i ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

Megjithatë Paneli Shqyrtues i vë në dijeni AK, në çdo aktivitet duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60, 65 të LPP-së.

Prandaj bazuar shkurtimisht në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për Çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK

1x1 OE ankues

1x1 Arhivës së OSHP-së;

